



Albania
Investment
Council

Improving Transparency and Investment Climate

Këshilli i Investimeve

RAPORTI MBI AKTIVITETIN E KI 2020

MARS 2021

Transformimi i dialogut në format të ri

Vazhdimi i dialogut në 'normalitetin e ri'

Gjatë këtij viti të paprecedentë, mbledhjet e Këshillit të Investimeve mbetën një mundësi e shkëlqyer për të gjithë aktorët për të vazhduar diskutimin dhe dialogun. Gjatë këtij viti, ri-modeluam metodologjinë tonë të punës dhe ndërveprimin me palët e interesit në kontekstin e një situatë plot pasiguri, duke gjetur qasje efektive për të mbështetur platformën në "normalitetin e ri". Suksesi ynë nuk do të kishte qenë i mundur pa gatishmërinë dhe përkushtimin e partnerëve tanë për t'u përfshirë në tematikat e përzgjedhura me kujdes dhe të votuara nga anëtarët tanë.

Këshilli i Investimeve (KI) ka si qëllim rritjen e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë duke kontribuar në institucionalizimin e dialogut mbi politikat në vend. KI kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke ndihmuar në përmirësimin e institucioneve, ligjeve dhe politikave që nxisin mirëfunksionimin e tregut.

KI kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe ka në përbërje përfaqësues të qeverisë, sektorit privat dhe partnerëve për zhvillim.

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).

Përmbajtja

06 Hyrje	18 Promovimi i bashkëpunimit ndër-institucional përmes koordinimit të grupeve të punës në sektorët prioritarë të ekonomisë	24 Dokumente	30 Vrojtim mbi ndikimin e Covid-19 tek biznesi (2020)
08 Aktivitetet kryesore gjatë 2020	20 Konsultime	25 Komunikim dhe vizibilitet	31 Planet për të ardhmen
10 Klima e Investimeve	22 Rekomandimet e përmbushura gjatë vitit 2020	26 Angazhimi i partnerëve	32 Numra të rëndësishëm, 2020
12 Mbledhje Plenare	23 Forcimi i zbatimit të reformave	28 Të tjera	33 Anëtarë të KI gjatë 2020



“Këshilli i Investimeve është platforma e dialogut publik - privat që prej vitesh ka marrë qartazi rolin e ndërmjetësit për sugjerime të politikave zhvillimore”

Ministrja e Financave dhe Ekonomisë, znj. Anila Denaj
Kryetarja e Këshillit të Investimeve
Tiranë, 14 tetor 2020

Objektivat e veprimtarisë gjatë 2020

Në përputhje me objektivin kryesor të KI për forcimin e besimit midis aktorëve kryesorë dhe institucionalizimin e dialogut mbi politikën që kanë të bëjnë me klimën e investimeve në vend, puna e Sekretariatit (një organ i pavarur përgjegjës për punën analitike, zhvillimin dhe organizimin e aktiviteteve të Këshillit) u bazua në shtyllat e mëposhtme:

ANALIZIMI I ÇËSHTJEVE QË KANË TË BËJNË ME KLIMËN E INVESTIMEVE – bazuar në vërtetimet vjetore; konsultimet në nivel kombëtar në formën e grupeve të fokusuara, hulumtimet e raporteve kombëtare dhe ndërkombëtare, monitorimit të treguesve kryesorë të zhvillimit ekonomik të vendit, ngritjen e grupeve të punës për sektorët prioritarë, etj.

MUNDËSIMI I KUSHTEVE PËR NJË DIALOG TË STRUKTURUAR – duke përgatitur një axhendë gjithëpërfshirëse të tematikave që do të trajtohen në mbledhjet e KI përmes procesit të kujdesshëm të votimit dhe konsultimit, duke organizuar mbledhje plenare ku mirë-përfaqësimi sigurohet tek

të dyja palët (publik dhe privat) dhe debati është gjithëpërfshirës dhe konstruktiv. Gjithashtu, përgatitja dhe shpërndarja në kohë e dokumenteve teknike të konsultuara gjerësisht dhe dokumentimi i diskutimeve me procesverbalin përkatës, të gjitha të publikuara në mënyrë transparente për publikun nëpërmjet faqes së internetit të KI.

AVOKIMI PËR NDËRMARRJEN E NDËRHYRJEVE KRYESORE NË NIVEL POLITIKASH – nëpërmjet shtjellimit dhe diskutimit në grupet e punës të veprimeve/rekomandimeve prioritare për të mbështetur përmirësimet e nevojshme në nivel politikash; publikimin e intervistave përkatëse mbi klimën e

investimeve në mediat sociale, kontributin në aktivitete të ndryshme të shoqatave të biznesit me fokus mbi klimën e investimeve, bashkëpunimin me universitete dhe platforma të tjera, etj.

MONITORIMI SISTEMIK I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE TË KI dhe ndjekja me autoritetet përkatëse, përfshirë edhe ngritjen e një baze të dhënash për matjen e rezultateve. Këtë vit, Sekretariati ka konsoliduar më tej instrumentet e raportimit mbi monitorimin e rekomandimeve të KI duke raportuar ecurinë tek anëtarët dy herë në vit gjatë mbledhjeve plenare të KI, pasuar më pas me publikimin e dokumenteve përkatëse përmbledhëse mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Hyrje

Këshilli i Investimeve (KI) mundëson dhe lehtëson institucionalizimin e dialogut në nivel politikash dhe zhvillimin e besimit të ndërsjellë midis biznesit dhe qeverisë. KI kontribuon në reformat kombëtare dhe procesin e tranzicionit ekonomik duke përmirësuar institucionet, ligjet dhe politikat që promovojnë funksionimin dhe efikasitetin e tregut. Pavarësisht krizës së jashtëzakonshme shkaktuar prej pandemisë së Covid-19 gjatë 2020, KI vazhdoi të perceptohet nga biznesi dhe qeveria si platforma më konstruktive për dialogun publik-privat në vend.

Gjatë këtij viti, Sekretariati përgatiti 3 analiza teknike me kontribut të vlefshëm nga anëtarët dhe partnerët e tij, 1 përmbledhje me propozime bazuar mbi sugjerime të parashtruara nga dhomat e tregtisë dhe shoqatat e biznesit për kapërcimin e problematikave kryesore të biznesit shkaktuar prej Covid-19, zhvilloi 1 anketë në rang kombëtar me pjesëmarrjen e 833 bizneseve në lidhje me perceptimin e tyre “Mbi Impaktin e Covid-19 mbi Biznesin” dhe 1 pyetësor me 37 kompani agro-përpunuese për të identifikuar potencialet e investimeve në sektor.

109 përfaqësues të biznesit morën pjesë në të gjitha mbledhjet e KI, grupet e punës dhe tryezat e tjera të organizuara nga Sekretariati, ndërsa totali i rekomandimeve të miratuara nga qeveria në fund të vitit 2020 arriti 94 nga 245 rekomandime të lëshuara nga KI (2015-2020).

Fokusi i punës së KI gjatë 2020:

- Taksat vendore dhe ndërveprimi midis bizneseve dhe bashkive
- Impakti i Covid-19 mbi biznesin & masat për rimëkëmbjen e ekonomisë post-COVID-19
- Stimulimi i investimeve në sektorin e agro-përpunimit

Ky raport përmbledh aktivitetet kryesore të KI si dhe rezultatet e punës së tij në trajtimin e çështjeve të ndryshme të klimës së investimeve, të cilat u ndoqën me mjaft interes si nga ana e qeverisë ashtu edhe nga sektori privat.


Arritjet kryesore të punës së KI dhe Sekretariatit gjatë 2020:

- » Roli proaktiv i Sekretariatit të KI në ndërmarrjen e vrotimit të parë në vend “Mbi Ndikimin e Covid-19 mbi Biznesin”;
- » Shpërndarja në kohë tek anëtarët e KI dhe partnerët (si dhe botimi për publikun e gjerë) të njoftimeve përditësuese mbi masat ligjore të marra gjatë situatës emergjente;
- » Dy mbledhje plenare të dedikuara për identifikimin e impaktit të Covid-19 mbi biznes dhe opsionet për rimëkëmbjen e ekonomisë post-Covid-19;
- » Lehtësimi i pesë grupeve të punës (6 mbledhje me më shumë se 54 pjesëmarrës), të krijuar midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) për ndjekjen e rekomandimeve të KI-së;
- » Konsultimi i një legjislacioni të rëndësishëm sikurse është Ligji “Për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Startup-eve Inovative” me kërkesë të Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes (njëkohësisht edhe anëtar i KI-së).

Gjatë këtij viti të pazakontë, vihet re pjesëmarrja dhe angazhimi i plotë i Kryetares së KI-së në të gjitha mbledhjet plenare, niveli i lartë i pjesëmarrjes dhe kontributit të anëtarëve të KI-së, si dhe ndjekja e diskutimeve nga një numër në rritje i vëzhguesve—duke riafirmuar kështu angazhimin e tyre në këtë platformë.

Gjatë vitit 2020, KI punoi në koherencë me politikën në vend nëpërmjet ofrimit të studimeve analitike dhe përfshirjes në dialog të aktorëve me ndikim, duke vijuar më pas me aktivitete dhe avokim. Në 4 mbledhje plenare të organizuara, KI miratoi 57 rekomandime. Ajo që nevojitet të nënvizohet është një përshpejtim në “kohën e zbatimit” të rekomandimeve të KI; për shembull nga 25 rekomandime të zbatuara (në masë 70-100%) dhe 13 në process gjatë 2020, 8 u lëshuan në vitin 2020 dhe 9 në 2019.

Informacioni në këtë dokument pasqyron aktivitetet vetëm për periudhën raportuese.



Aktivitetet

kryesore gjatë 2020



Klima e Investimeve

Përballja e vendit me dy emergjencave civile të njëpasnjëshme, tërmeti i datës 26 nëntor 2019 dhe pandemia globale e Covid-19, ulën ndjeshëm parashikimet e rritjes ekonomike të Shqipërisë gjatë vitit 2020. Në Raportin e saj të Rregullt Ekonomik (vjeshtë 2020)¹, Banka Botërore parashikoi një rënie të rritjes reale të vendit me 8.4 %, ndërsa BERZH në raportin e tij mbi Perspektivat Rajonale Ekonomike² parashikoi një rënie prej 9%. Pavarësisht parashikimeve fillestare, ekonomia shqiptare ra me vetëm 3.3% gjatë vitit 2020, krahasuar me një vit më parë, bazuar në të dhënat paraprake të INSTAT.

Inflacioni mbeti nën objektivin e Bankës së Shqipërisë prej 3% dhe regjistroi 1.6%, me 0.2 p.p. krahasuar me 2019. Hyrjet e IHD-ve ranë me 13.1% krahasuar me 2019, ndërsa stoku i IHD-ve u rrit me 8.2%³. Përsa i përket fluksit hyrës të IHD-ve, Holanda kryesoi për të dytin vit radhazi, ndonëse me një ritëm në rënie. Furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe kondicionim vazhdoi të ishte aktiviteti më tërheqës për IHD-të. Shqipëria renditet e dyta në rajon për IHD-të me 7.9% të PBB-së. Shkalla e papunësisë u rrit gjatë vitit 2020, me 0.2 p.p. krahasuar me vitin 2019.

KRIZA E COVID-19: Që prej muajit mars, në përgjigje të situatës shkaktuar prej pandemisë së Covid-19, qeveria shqiptare ndërmori masa të rrepta për të menaxhuar krizën me qëllim kufizimin e humbjeve njerëzore dhe

financiare. Qeveria nxori një mori dekretesh të miratuara më pas nga Parlamenti. Gjendja e jashtëzakonshme për katastrofat natyrore, e vendosur pas tërmetit të nëntor 2019, u zgjat deri në qershor 2020. *Dinamika ligjore / rregullatore:* Që prej 9 mars 2020, një numër masash përshkallëzuese u morën në Shqipëri, me një dinamikë mjaft të shpejtë të ndryshimeve ligjore dhe rregullatore. Masa të tilla fillimisht ishin të natyrës kufizuese dhe më vonë të natyrës së zbutur, të cilat synonin të mbanin nën kontroll situatën e pandemisë dhe të ulnin numrin e të infektuar nga Covid-19, me qëllimin kryesor për të monitoruar sa më mirë situatën. Dinamika e ligjeve dhe akteve nënligjore të sapo ndërmarra ndikoi në veprimtarinë e institucioneve të administratës qendrore dhe lokale, si edhe në shumë institucione të tjera të pavarura.

Pavarësisht parashikimeve fillestare, **ekonomia shqiptare ra me vetëm 3.3% gjatë vitit 2020**, krahasuar me një vit më parë, bazuar në të dhënat paraprake të INSTAT.

EKONOMI: Mbi 50% e të gjithë aktivitetit ekonomik në vend vazhdoi me kapacitet të reduktuar, pavarësisht

mbylljes së vendit. Aktiviteti ekonomik u kthye gradualisht në normalitet për pjesën më të madhe të aktivitetëve brenda datës 1 qershor. Për të zbutur impaktin e Covid-19 në ekonomi, qeveria miratoi dy paketa mbështetëse për qytetarët dhe bizneset e prekura prej pandemisë me një total prej 45 miliardë lekë (2.8 përqind e PBB-së) ku përfshiheshin shpenzimet e buxhetit, garancitë sovraane dhe shtyrja e taksave. Për të ndihmuar bizneset dhe palët e interesuara me përditësimet e shpeshta dhe të vazhdueshme, Sekretariati dedikoi një "kënd informacioni" në faqen e internetit të KI me informacion të përditësuar mbi masat ligjore dhe rregullatore të sapo vëna në fuqi, duke publikuar më pas një **raport të konsoliduar përmbledhës** me të gjitha aktet dhe masat e marra deri në gusht të vitit 2020.

¹ <https://www.worldbank.org/en/region/eca/publication/western-balkansregular-economic-report>

² <https://www.ebrd.com/what-we-do/economic-research-and-data/rep.html>

³ Për më shumë informacion: <https://www.investment.com.al/albaniaeconomic-outlook/>



Nëpërmjet nënshkrimit të një Memorandumi të ri, Qeveria Shqiptare dhe BERZH rinovuan angazhimin e tyre për të mbështetur Këshillin e Investimeve – një formë mbështetjeje nga ana e BERZH-it në kuadër të përpjekjeve për pranimin e Shqipërisë në BE.

Në përputhje me Ligjin 71/2019 në fuqi, Korporata Shqiptare e Investimeve, u krijua si një kompani aksionere në Qendrën Kombëtare të Biznesit më 15.07.2020. Paketa ligjore për formën e fiskalizimit (prezantuar në 2019), u konsolidua përfundimisht gjatë vitit 2020 dhe faturimi elektronik biznes-qeveri filloi zbatimin më 1 janar 2021. Gjithashtu, Qeveria Shqiptare shtyu sërish kohëzgjatjen e Ligjit 55/2015 "Për Investimet Strategjike" deri më 31 dhjetor 2021.

Në mbyllje të vitit 2020, MFE dhe Ministria për Mbrojtjen e Sipërmarrjes hapën për konsultim publik draft ligjin "Për Mbrojtjen dhe Zhvillimin e Start-upëve Inovative", i cili u konsultua gjerësisht edhe nëpërmjet Këshillit të Investimeve.

POLTIKË: Aktivitetet parlamentare u ndikuan nga dorëzimi i mandateve nga ana e opozitës. Vazhdimësia institucionale u siguroi përmes plotësimit gradual të vendeve të lira të parlamentit. Kodi i Ri Zgjedhor dhe ndryshimet në Kushtetutë në lidhje me sistemin zgjedhor u miratuan në kuadër të zgjedhjeve të ardhshme politike që do të mbahen më 25 prill 2021. Viti 2020 u mbyll pa deklarata nga BE mbi zgjerimin, kuadrin negociues apo mbi konferencën e parë për anëtarësimin e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.

Mbledhje Plenare

Si do të ndikonte transparencja mbi taksat & tarifat vendore dhe paanshmëria në vendimet e këshillave bashkiakë në forcimin e marrëdhënies me sektorin privat?

infrastruktura, uji, energjia etj.). Në këtë kuptim zhvillimi ekonomik në nivel vendor ndihmon për të hedhur themelet e një prosperiteti lokal dhe kombëtar.

- » **Cilat** janë sfidat kryesore të biznesit gjatë bashkëveprimit të tyre me bashkitë?
- » **Sa** i drejtë është raporti kosto/cilësi për shërbimet lokale?
- » **A duhet** të përfshihen bizneset në vendimmarrjen bashkiake?


REKOMANDIME KRYESORE

- Harmonizimi i legjislacionit në fushën e taksave dhe tarifave vendore me legjislacionin e ri për vetëqeverisjen vendore.
- Publikimi dhe rritja e transparencës mbi taksat dhe tarifat vendore për biznesin.
- Përgatitja, bërja publike dhe lehtësisht e arritshme e një seksioni të dedikuar mbi procedurat e ankimimit administrativ në njësitë e vetëqeverisjes vendore.
- Dixhitalizimi i shërbimeve administrative në nivel vendor në kuadër të reformës së derregullimit.
- Regjistrimi në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës të aseteve/pasurive të paluajtshme nën administrimin e bashkive.

Pavarësisht progresit të arritur në Reformën Administrativo-Territoriale, ka ende sfida të pazgjidhura për njësitë e vetëqeverisjes vendore. Mirëadministrimi fiskal mbetet parakusht i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik lokal dhe stimulimin e investimeve. Zhvillimi ekonomik lokal është një proces i partneritetit strategjik, i cili ndihmon në: a) rritjen e produktivitetit (një objektiv kryesor ekonomik) me anë të stimulimit të investimeve në bizneset e reja apo edhe ato ekzistuese me potencial të lartë të rritjes; dhe b) krijimit të kushteve lokale për të siguruar rritje të qëndrueshme mbi ekonominë lokale/kombëtare (p.sh.:

“Për shkak të akteve të paqarta administrative të lëshuara për pagesën e detyrimeve, bizneset janë të detyruara të shpenzojnë shumë kohë duke pritur zgjidhje nga vetë bashkitë dhe në disa raste të ankimojnë në gjykata ku koha e shqyrtimit është e tejzgjatur. Ndërkohë, bazuar në ligj, biznesi detyrohet të parapaguajë detyrimin dhe të penalizohet me bllokimin e llogarive bankare si të kompanisë ashtu edhe të administratorëve. Anëtarët e Confindustria-s shprehin gatishmërinë e tyre të bashkëpunojnë me strukturat qendrore dhe lokale në drejtim të gjetjes së një zgjidhjeje optimale.

ALTIN IBRO,
Confindustria Albania, 27 Janar 2020



Si duhet që qeveria dhe sektori privat të bashkojnë forcat gjatë pandemisë së Covid-19?

Masat e ndërmarra nga Qeveria Shqiptare mbi parandalimin e përhapjes së Covid-19 kanë ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë aktivitetin e sipërmarrjeve private në Shqipëri. Nisur nga situata e paprecedentë që bizneset duhej të përjetonin, përfaqësuesit e dhomave të tregtisë dhe shoqatave të biznesit përcollën pranë Sekretariatit propozime konkrete për lehtësimin e bizneseve përmes ndërhyrjeve specifike.

» **Cilat** janë perceptimet e biznesit në lidhje me masat financiare dhe ekonomike të marra nga qeveria për të përballuar pasojat e pandemisë?

» **Pse** dialogu publik-privat është jetik në periudhë krizash?

“Shoqatat/dhomat e tregtisë në bashkëpunim edhe me institucionet qendrore të gjejnë mekanizmat e duhur për të kapërcyer krizën. Janë rreth 43.000 sipërmarrje me mbi 14 milionë lekë xhiro në vit. Vetëm 1.000 janë VIP, nga të cilat jo më shumë se 300 mund ta përballojnë situatën për 3-4 muaj. Gjithë pjesa tjetër, pra, 42.700 kompani janë në momentet më delikate të ekzistencës së tyre.

NIKOLIN JAKA,
Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, 14 prill 2020

SUGJERIME KRYESORE

- Volumi i garancisë sovrane është i vogël për të mbuluar nevojat e biznesit për garanci/kolateral më të gjatë. Shoqatat/dhomat e tregtisë në bashkëpunim edhe me institucionet qendrore të gjejnë mekanizmat e duhur, duke i bërë thirrje edhe organizmave ndërkombëtarë për të mundësuar donacione dhe financime që i duhen sipërmarrjes.
- Si qeveria vendore ashtu edhe ajo qendrore të shtyjnë detyrimet fiskale, pra nuk duhet të ketë detyrime qoftë në sistemin fiskal edhe në respektim të kontratave për veprat publike që janë në funksion.
- Të gjitha bizneset, pavarësisht madhësisë, të kenë mundësi aksesit në Fondet e Emergjencës Covid-19 në mënyrë që të vazhdojnë aktivitetin gjatë kësaj periudhe. Kreditë që do të garantohen nga ky fond duhet të akordohen me norma minimale ose zero, duke marrë parasysh që fondi i garancisë ndihmon institucionet financiare që të ulin ndjeshëm rrezikun e tyre.
- Qeveria që të konsultohet me palët e interesit përpara se të merren vendime me pasoja të rëndësishme për bizneset. Organizatat përfaqësuese të biznesit janë të domosdoshme gjatë kësaj krize dhe duhet të jenë pjesë e tryezës së diskutimit. Kontributi i tyre do të rrisë ndjeshëm cilësinë dhe qëndrueshmërinë e ligjeve dhe njëkohësisht efikasitetin e masave në planin afatgjatë.
- Të garantohet menjëherë likuiditeti i kompanive, të prekura nga urgjenca epidemiologjike, përmes pezullimit të taksave dhe pagesave të kontributeve.

Çfarë duhet të jetë në fokus të reformave të politikave të ardhshme për të adresuar shqetësimet e biznesit post-Covid-19 – likuiditeti, punësimi, barra fiskale, dixhitalizimi, tërheqja e IHD-ve, etj.?

Me kërkesë të Kryetares së Këshillit të Investimeve, anëtarët dhe partnerët e KI vendosën që masat e ardhshme të qeverisë të shihen në një kornizë më të gjerë, në periudhë afatmesme dhe afatgjatë. Qëllimi ishte që të adresohen jo vetëm nevojat e menjëhershme të biznesit për sa i përket likuiditetit dhe punësimit, por edhe për të përcaktuar pikat e rëndësishme të zhvillimit

» **Cilët** skenarë mund të funksionojnë për rifillimin e ekonomisë post Covid-19?

» **Si** formalizimi i ekonomisë do të kishte zbutur ndjeshëm efektet negative të krizës?

ekonomik të vendit, burimet e rritjes dhe mbledhjen e të ardhurave publike, vlerësimin e ndërhyrjeve fiskale dhe rimëkëmbjen e sektorëve prioritarë për një periudhë të paktën 5-vjeçare. Kjo ishte në përputhje edhe me ambiciet dhe angazhimin e Qeverisë Shqiptare për të prezantuar brenda muajit qershor 2020 planin e rimëkëmbjes ekonomike dhe veçanërisht të sektorëve prioritarë si turizmi dhe prodhimi.

SUGJERIME KRYESORE

- Hartimi i një politike inkurajuese për tërheqjen e investimeve të huaja “Albania-The Gateway to the Balkans”.
- Ndërtimi i një strategjie afatgjatë për uljen e informalitetit që të shmangët konkurrenca e pandershme dhe të nxiten pagesat elektronike si një mënyrë për të shmangur varësinë nga paraja në dorë dhe njëkohësisht të ulet informaliteti.
- Ndërmarja e politikave aktive pas COVID-19 me fokus trajnimin e fuqisë punëtore si një faktor i rëndësishëm për nxitjen e investimeve të qëndrueshme.
- Krijimi i një fondi garancie për kreditimin e sektorëve ekonomik prioritarë prej 500 milionë EUR, të ngritur me kontributin e qeverisë dhe donatorëve për lehtësimin e aksesit në kredi për bizneset që operojnë në sektorin e turizmit, industrive prodhuese, bujqësisë, shërbimeve, transportit dhe specifkisht për gratë sipërmarrëse, etj.

“Materiali i përgatitur nga Sekretariati është i mirë-strukturuar dhe ka propozime mjaft interesante. Sektori i turizmit duhet të fokusohet në zgjerimin e kërkesës dhe incentivimin e turistëve. Gjithashtu, tregtia elektronike dhe shtimi i shërbimeve publike online (firma elektronike, etj.) janë një domosdoshmëri për të ecur më tej.

MARYAM SELIM,
Banka Botërore, 5 qershor 2020

A mund të rrisim vlerën e shtuar për bimët mjekësore dhe aromatike (MBA), arrorët, frutat dhe perimet për të promovuar konkurrueshmërinë e produkteve shqiptare në tregun rajonal dhe botëror?

Industria agro-përpunuese konsiderohet se ka potenciale të qenësishme për investime, veçanërisht perimet, frutat dhe BMA. Ndër produktet e zgjedhura, gështenjat, domatet dhe BMA konsiderohen si tre produktet kryesore që kanë më shumë potencial për agro-përpunim. Kompanitë shprehin besim në potencialin e sektorit të agro-përpunimit dhe janë të gatshme të investojnë. Shumica e përfaqësuesve të kompanive eksportuese dhe supermarketeve konfirmuan vullnetin e tyre për të rritur furnizimet nga tregu i brendshëm

- » **Cilat** ndërhyrje (qeveri-biznes-donator) në nivel sektorial mund të përshpejtojnë NVM-të agro-përpunuese për të zgjeruar investimet aktuale dhe/apo të reja?
- » **Si** të maksimizohen potencialet e vendit me fokus në imazhin e vendit, skemat e funksionimit të tregut, zëvendësimet e importit, informalitetin, rritjen e aksesit në financim, zhvillimin e forcës së punës?


nëse kompanitë vendase do të mund të siguronin sasi të mëdha të produkteve me standardet e kërkuara dhe çmime konkurruese.

REKOMANDIME KRYESORE

- Në mënyrë që të incentivohet bashkëpunimi i fermerëve në katër sektorët kryesorë të lartpërmendur, rekomandohet të vendosen incentiva dhe skema mbështetëse të synuara për katër nën-sektorët.
- Nxitje/stimulim për rritjen e integritit të zinxhirit të vlerës dhe furnizimit me lëndë të parë për agro-përpunimin në katër nën-sektorët e zgjedhur.
- Krijimi i një Njësie të Inteligjencës së Tregut (mundësisht brenda AIDA, AZHBR apo një institucioni tjetër, si p.sh. Universiteti Bujqësor) për të siguruar informacion të përditësuar mbi nevojat aktuale të tregut të brendshëm dhe të jashtëm për sa i përket produkteve në përdorim të freskët ose në industrinë e përpunimit.
- Diversifikimi i skemave mbështetëse të granteve dhe produkteve bankare gjithashtu, për sa i përket nën-sektorëve të bujqësisë.
- Krijimi i skemave të mbulimit të sigurimeve për produktet e biznesit bujqësor duke prezantuar shtetin si ndërmjetës.

“Ndoshta ka ardhur koha për krijimin e një agjencie për promovimin apo shqyrtimin e skemave me qëllim lehtësimin e eksporteve të produkteve “Made in Albania”. Ndryshe nga AIDA (e cila mund të vazhdojë të mbetet një agjenci e fokusuar në përthithjen e investimeve të reja), struktura e re e propozuar të merret vetëm me produktet “Made in Albania” dhe promovimin e eksporteve, bazuar mbi një legjislacion mbështetës dhe një plan zhvillimi ekonomik 10-vjeçar—të strukturuar në bashkëpunim me biznesin.

INES MUCOSTEPA,
Unioni i Dhomave të Tregtisë dhe
Industriës, 10 nëntor 2020



Promovimi i bashkëpunimit ndër-institucional përmes koordinimit të grupeve të punës në sektorët prioritarë të ekonomisë



Një fokus i veçantë u vendos gjatë këtij viti në koordinimin dhe ndjekjen e grupeve të punës në sektorë specifikë—për sigurimin në kohë të rezultateve. Në janar 2020, me dekrete të përbashkët midis Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, tre grupe pune u zyrtarizuan, përkatësisht, në fushën e energjisë, agro-industrisë, dhe TIK (dixhitalizimi). Sekretariati monitoroi nga afër ecurinë dhe lehtësoi bashkëpunimin institucional në këto grupe pune. Gjithashtu, me kërkesë të kryetares së KI, Sekretariati u angazhua në krijimin e dy grupeve të tjera të punës për të përshpejtuar zbatimin e disa rekomandimeve specifike nga mbledhja e KI “Mbi Ndërvëprimin Bashki-Biznes”. Angazhimi i Zëvendës Ministrave në rolin e drejtuesve të grupeve përkatëse të punës (përfshirë stafin teknik të ministrive të linjës) ndihmoi në kapërcimin e çdo vonese pavarësisht krizës që po kalohej, veçanërisht përsa i përket dhënies në kohë të komenteve në ndjekje të ecurisë kundrejt delivrit.

Gjatë 2020, Sekretariati lehtësoi punën e 5 grupeve të punës (6 mbledhje me pjesëmarrjen e më shumë se 54 pjesëmarrësve).

Krijimi dhe koordinimi ligjor i grupeve të punës ndihmoi në shtjellimin më të mirë të rekomandimeve të KI dhe rrjedhimisht caktimin më të mirë të përgjegjësive dhe detyrave/afateve reale. Ndihmoi gjithashtu për të kuptuar më mirë sfidat e koordinimit ndërmjet ministrive në drejtim të respektimit të detyrave dhe afateve. Udhëheqja dhe mbështetja e ofruar nga qeveria ka qenë e domosdoshme për të drejtuar procesin dhe për të dhënë rezultate.

GRUPE PUNE MBI ENERGJINË

Ngritur për të vlerësuar potencialet për investime në sektorin e energjisë dhe për të koordinuar një plan pune me të gjitha palët e përfshira me qëllim krijimin e kushteve të favorshme për investime në sektorin e energjisë. Ky grup pune pritej të lehtësonte dhe propozonte procedurat e nevojshme ligjore dhe rregullatore që vlerësojnë, përgatisin dhe zbatojnë veprimet e nevojshme konkrete për zhvillimin e sektorit të energjisë. Rezultati i këtij grupe pune është ende në proces.

GRUP PUNE MBI TIK (FOKUS DIXHITALIZIMI)

Përshpejtimi i Axhendës Dixhitale. Përmes koordinimit të takimeve dhe diskutimeve midis anëtarëve, Sekretariati shtyu koordinimin dhe bashkëpunimin institucional për zbatimin e 7 rekomandimeve të lëshuara nga KI me fokus zgjerimin e rrjetit broadband në vend, vlerësimin e gatishmërisë së NVM-ve në ofrimin e shërbimeve online, duke analizuar të dhëna për përdorimin, aksesin dhe cilësinë e shërbimeve TIK nga biznesi, si dhe ndjekjen e hartimit të një strategjie për aftësitë dixhitale.

GRUP PUNE MBI POTENCIALET E INVESTIMEVE NË AGRO-PËRPUNIM – PROMOVIMI I PRODUKTEVE “MADE IN ALBANIA”

Anëtarët e grupit të punës shkëmbyen informacione mbi punën e kryer midis ministrive dhe shqyrtuan opsionet për të ndërmarrë veprime konkrete për promovimin e sektorit të agro-përpunimit në kuadër të rimëkëmbjes ekonomike të vendit, veçanërisht post-Covid-19. Grupi i punës identifikoi 4 grupe konkrete me potencial investimi në sektorin e agro-përpunimit si aroret, domatet, lëngjet e frutave dhe bimët mjekësore dhe aromatike. Grupi identifikoi gjithashtu sfidat kryesore të biznesit dhe kërkesat për mbështetje - kryesisht në lidhje me informacionin dhe edukimin mbi tregun, standardet dhe certifikimin, si dhe aksesin në financim. Bazuar në arritjet e këtij grupi teknik, Sekretariati bashkëpunoi me ekspertë të fushës për të zhvilluar disa karta teknologjike për këto produkte për të shërbyer si një udhëzues për investitorët e mundshëm në këto nën-sektorë të përzgjedhur.

GRUP PUNE PËR TRAJTIMIN E ÇËSHTJES SË BLOKIMIT DHE ZHBLOKIMIT TË LLOGARIVE BANKARE TË TATIMPAGUESVE NGA BANKAT TREGTARE BAZUAR NË URDHËRAT PËRKATËS TË LËSHUAR NGA DREJTORITË E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NË BASHKI.

Pas diskutimeve intensive midis të gjitha palëve të interesuara, dhe ndjekja nga Sekretariati dhe shoqatat dhe dhomat e biznesit (anëtarë të biznesit në KI), Udhëzimi Nr. 24 datë 02.09.2008 u përmirësua përfundimisht në përfundim të vitit 2020. Ndryshimet në Udhëzimin Nr.24, datë 02.09.2008 “Për Procedurat Tatimore” sqaruan rastet kur administrata tatimore mund të bllokojë/ sekuestrojë llogaritë bankare të administratorit/aksionerit për detyrimet përkatëse të kompanisë. Udhëzimi qartësoi se llogari të tilla individuale mund të bllokohen, vetëm me vendim të gjykatës dhe pasi të jenë përmbushur kushtet specifike nga legjislacioni për sipërmarrësit dhe kompanitë tregtare. Diskutimi në grupin e punës do të kontribuojë më tej në të gjitha procedurat operacionale që përfshijnë disa palë të interesuara (banka, administratë tatimore, kompani, bashki, etj.) që do të jenë objekt diskutimi në muajt e ardhshëm, pas miratimit në vitin 2020 të legjislacionit për regjistrin e llogarive bankare.

GRUPI I PUNËS PËR TRAJTIMIN E DISA SHQETËSIMEVE TË NGRITURA NGA BIZNESET NË LIDHJE ME VENDOSJEN E TAKSAVE DHE TARIFAVE VENDORE NGA PESË BASHKI (FIER, KUKËS, PUKË, SELENICË, TROPOJË).

Diskutimet u përqëndruan në (1) propozimet konkrete në lidhje me kornizat e ndryshme aktuale ligjore, (2) nevojat për të ndërtuar një manual për të shpjeguar qartë metodologjinë për vendosjen e taksave dhe tarifave të qeverisjes vendore për të cilat MFE shprehu angazhim, (3) transparencën mbi taksat dhe tarifatat të vendosura nga bashkitë dhe çështje të tjera komplekse me të cilat përballat biznesi për të paguar taksat lokale.

Konsultime




Përdorimi Efikas i Skemave Publike për Garantimin e Kredive Rrit Mundësinë e Financimit të Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme në Shqipëri – Seminar në bashkëpunim me MFE dhe BB

Ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) në Shqipëri janë kontribuuese të rëndësishme në ekonominë shqiptare, duke përfaqësuar 99.8 përqind të ndërmarrjeve aktive. Ky sektor karakterizohet në përgjithësi nga informaliteti i lartë (veçanërisht në bujqësi), disponueshmëria e kufizuar e kolateralit dhe nivelet e ulëta të kapacitetit financiar. Qasja e kufizuar tek financimet, veçanërisht tek kreditë bankare, përbën një sfidë për NMVM-të në Shqipëri. Për të diskutuar në lidhje me mënyrat e përmirësimit të qasjes së NMVM-ve tek financimet përmes këtyre skemave, duke i bërë ato më efikase dhe efektive, Sekretariati i Këshillit të Investimeve

organizoi një seminar të përbashkët virtual me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Bankën Botërore.

SUGJERIME KRYESORE

Përfaqësuesit nga sektori privat e vlerësuan temën mjaft aktuale dhe të rëndësishme (veçanërisht në kontekstin e pandemisë) dhe theksuan nevojën për transparencë dhe ndërgjegjësim më të madh mbi skemat ekzistuese të garantimit të kredive në vend. Ata theksuan se përmirësimi i aksesit në financim për NMVM-të në vend duhet të adresohet në mënyrë holistike dhe strategjike, duke adresuar njëkohësisht si ofertën ashtu edhe kërkesën.



Konsultimi i draft Ligjit “Për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Start-upeve Inovative” – një hap i rëndësishëm drejt një kuadri të konsoliduar normativ

Konsultimi i projekligjeve të cilët kanë një impakt të drejtpërdrejtë në klimën e investimeve është një nga shtyllat kryesore të punës së Këshillit të Investimeve. Konsultimi i një pjese të rëndësishme të legjislacionit siç është projektligji “Për Mbështetjen dhe Zhvillimin e Bizneseve Inovative”, tërhoqi vëmendjen e shumë aktorëve të sektorit privat. Projektligji për zhvillimin e start-upeve inovative synon ta bëjë Shqipërinë me konkurrese nëpërmjet stimulimit dhe mbështetjes së ekosistemit që rregullon marrëdhëniet e aktorëve publik dhe privat dhe universiteteve—një funksion të cilin edhe KI është përpjekur të përmirësojë nëpërmjet dialogut të duhur midis palëve që prej vitit 2015.

SUGJERIMET KRYESORE

Pjesëmarrësit ngritën komente që kishin të bënin me përkufizimet në ligj, nevojën për infrastrukturë për mbështetje të inovacionit, nevojën për bashkëpunim rajonal, zhvillimin e krijimit të fondeve për kërkim dhe zhvillim, nevojën për më shumë incentiva fiskale, etj. Gjithashtu, gjatë këtij takimi, Sekretariati ngriti disa pika për përmirësime apo sqarime të mëtejshme, të cilat u morën në konsideratë nga hartuesit e këtij legjislacioni.

Rekomandimet e përmbushura gjatë vitit 2020

Përmes **dialogut efektiv** publik-privat dhe përfshirjes së plotë të anëtarëve të tij, Këshilli i Investimeve ka analizuar dhe miratuar **245 rekomandime** për përmirësimin e klimës së investimeve në Shqipëri (2015-2020), nga të cilat **38%** janë tashmë të zbatuara dhe **14%** në process zbatimi.

Fushat kryesore të ndikuara nga zbatimi i rekomandimeve të KI-së lidhen kryesisht me:

- » **Rritjen e transparencës mbi incentivat dhe promovimin e investimeve në sektorë specifikë.** Theksojmë këtu përbushjen e rekomandimeve në plotësimin e kuadrit ligjor dhe rregullator në fushën e komunikimeve elektronike, energjisë së rinovueshme dhe fotovoltaike. Gjithashtu, përmirësime janë vërejtur si rezultat i rekomandimeve të përbushura përsa i përket subvencionimit të naftës për fermerët në sektorin e bujqësisë dhe rritjen e konkurrencës dhe forcimin e formalizimit në sektorin e turizmit, me ndikim të drejtpërdrejt në lehtësimin e hyrjes në treg dhe lojën e ndershme për zhvillimin e biznesit në këto sektorë.
- » **Stimulimin e ekspozimit të popullatës ndaj potencialeve të TIK përmes bashkëpunimit me bizneset** (për të subvencionuar kostot e pajisjeve dixhitale), promovimin e sektorit të TIK si një mundësi për investime përmes platformës së unifikuar Global Digit City, dhe rishikimin e kuadrit ligjor përkatës - duke iu përgjigjur kështu rekomandimeve të dhëna për reduktimin e informalitetit në sektor.
- » **Integrimin e rekomandimeve të KI në procesin e përgatitjes dhe zbatimit të**

dokumenteve strategjike të qeverisë së vendit, të tilla si:

- *Programi i Reformës Ekonomike 2020* - materializimi i një prej aktiviteteve të planifikuara në programin e reformës ekonomike (ERP): "krijimi i një platforme dixhitale të centralizuar që përmban informacion mbi skemat dhe burimet ekzistuese dhe të ardhshme të financimit, si një mjet i rëndësishëm në internet për aksesin e NVM-ve për financim" përmes diskutimeve të mëtejshme në grupin e punës të KI dhe diskutimit me donatorët, MFE dhe AIDA.
- *Strategjia e re e Biznesit dhe Investimeve (BITS 2021 - 2027)* aktualisht duke u hartuar nga MFE dhe GIZ përfshin rekomandime specifike të KI të fokusuara në incentivat për tërheqjen e investimeve, sektorët prioritarë për rimëkëmbjen e ekonomisë, zhvillimin e zonave ekonomike, aftësitë në punë, etj.
- » **Përshejtimin e Axfordës Dixhitale.** KI nxit institucionet publike të marrin në konsideratë nxitjen e investimeve publike në rrjetet broadband dhe të rishikojnë legjislacionin që aktualisht publikon pagesa si në bashki ashtu dhe në buxhetin e shtetit (brenda një viti). Si përgjigje, një grup pune u krijua nga Këshilli i Ministrave, i udhëhequr nga përfaqësuesit e MFE & MIE, duke punuar më specifikisht për këto çështje.

Forcimi i zbatimit të reformave

Zbatimi i rekomandimeve të KI është forcuar dhe bërë më efektiv për shkak të mbështetjes me projekte vijuese

Asistencë Teknike (Projekt) nga BERZH për përmirësimin dhe funksionimin e Efektivitetit të Platformës e-Lejet:

- » Vlerësimi i funksionaliteteve të platformës elektronike të lejeve të ndërtimit sipas metodologjisë së Bankës Botërore të të Bërit Biznes për vlerësimin e fushës së lejeve të ndërtimit;
- » Përgatitja e një manuali dhe procedurave të unifikuara për të gjithë përdoruesit e platformës;
- » Ndërtimi i kapaciteteve institucionale, ofrimi i informacionit dhe rritja e ndërgjegjësimit rreth platformës;
- » Përshejtimi i procesit të vendimmarrjes së e-lejeve përmes dixhitalizimit të mëtejshëm.

Produkti tjetër i pritshëm është përgatitja e një manuali të detajuar operacional, teknik dhe ligjor për platformën e-lejet.

Asistencë Teknike për Dixhitalizimin e NVM-ve

Gjatë muajve maj-qershor, Sekretariati në bashkëpunim me të gjithë anëtarët e KI (institucionet shtetërore, anëtarët e biznesit dhe partnerët ndërkombëtarë për zhvillim), luajtën një rol kryesor në ofrimin e ndihmës për qeverinë për të hartuar ndërhyrje të shpejtë me politika ekonomike mbështetëse ndaj biznesit në kuadër të pandemisë së Covid-19. Në aspektin ndër-sektorial u

theksua **domosdoshmëria për t'i dhënë përparësi dixhitalizimit dhe për të maksimizuar aksesin e bizneseve në Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK).**

Pas miratimit të rekomandimeve të KI, Ministria e Financave dhe Ekonomisë kërkoi mbështetjen e BERZH-it me asistencë teknike për zbatimin në veçanti të 2 prej këtyre rekomandimeve (në bashkëpunim gjithashtu me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve):

- » Hartimi i politikave për dixhitalizimin e NVM-ve, pas një analize të thellë dhe ofrimin e rekomandimeve në nivel politikash në lidhje me përmirësimin e aksesit të NVM-ve në shërbimet TIK;
 - vlerësimi i kërkesës për zgjidhje dixhitale nga NVM-të në të gjithë sektorët prioritarë të ekonomisë/krahinat e vendit;
 - vlerësimi i disponueshmërisë së produkteve të përshtatshme për të përbushur nevojat e NVM-ve në sektorë jo-dixhitalë;
 - rekomandimi i mjeteve, mekanizmave dhe politikave të nevojshme që mund të adresojnë ato nevoja që mund të ndihmojnë NVM-të të shfrytëzojnë përfitimet e teknologjisë ekzistuese së informacionit dhe komunikimit.
- » Përmirësimi dhe dixhitalizimi/centralizimi i informacionit mbi skemat dhe burimet ekzistuese dhe të ardhshme të financimit, si një mjet i rëndësishëm online për qasjen e NVM-ve në financim.

Dokumente



Kliko mbi titullin e dokumentit për ta shkarkuar

JANAR 2020

- ↓ Rekomandime të KI (2019)
- ↓ Mbledhje XIX - Axhenda
- ↓ Mbledhja XIX – Prezantimi PPT
- ↓ Mbledhja XIX – Nota Teknike
- ↓ Mbledhja XIX – Matrica e Rekomandimeve
- ↓ Mbledhja XIX – Minutat

PRILL 2020

- ↓ Mbledhja XX – Axhenda
- ↓ Mbledhja XX – Prezantimi PPT
- ↓ Mbledhja XX – Përmbledhje e Propozimeve të Biznesit
- ↓ Mbledhje XX – Përmbledhje e Sugjerimeve të Ngritura në Mbledhje
- ↓ Mbledhje XX – Minutat

QERSHOR 2020

- ↓ Mbledhje XXI – Axhenda
- ↓ Mbledhje XXI – Prezantim PPT
- ↓ Mbledhje XXI – Notë Përmbledhëse
- ↓ Mbledhje XXI – Matrica e Rekomandimeve
- ↓ Arritje të KI, 2019-2020
- ↓ Mbledhje XXI – Minutat

NËNTOR 2020

- ↓ Mbledhje XXII – Axhenda
- ↓ Mbledhje XXII – Prezantim PPT
- ↓ Mbledhje XXII – Përmbledhje Ekzekutive
- ↓ Mbledhje XXII – Notë Teknike
- ↓ Mbledhje XXII – Matrica e Rekomandimeve
- ↓ Mbledhje XXII – Statusi i Rekomandimeve
- ↓ Mbledhje XXII – Minutat

PUBLIKIME

- ↓ Raport mbi Aktivitetin e KI (2020)
- ↓ Gjetjet e Anketës “Impakti i Covid-19 mbi Biznesin” (2020)
- ↓ Vështrim mbi Treguesit Makro-Ekonomik (janar-dhjetor 2019)
- ↓ Vështrim mbi Treguesit Makro-Ekonomik (janar-qershor 2020)
- ↓ Progresi i Rekomandimeve të KI (qershor 2020)
- ↓ Përmbledhje mbi Aktet & Masat e Ndërmarra në Shqipëri gjatë Pandemisë së Covid-19 (gusht 2020)
- ↓ Fakte & Shifra (2020)
- ↓ Raporti i Monitorimit (2020)

Komunikim dhe vizibilitet



FAQJA E INTERNETIT

- » Rritje prej 20% të përdoruesve të faqes së internetit (8,790 përdorues në 2020 krahasuar me 7,296 përdorues në 2019)
- » Rritje prej 6% në shikimin e faqes (27,106 shikime në 2020 krahasuar me 25,682 shikime në 2019)

MEDIAT SOCIALE

- » Aktiv në 3 platforma: Facebook (që prej 2015), Twitter (2016), LinkedIn (2019)
- » Rritje prej 87% në numrin e ndjekësve: 2,128 ndjekës (2020) krahasuar me 1,140 (2019)
- » 52 postime në mediat sociale (një rritje e konsiderueshme krahasuar me vitet e mëparshme)

BULETINË TREMUJORË

- » Shpërndarë në mënyrë elektronike tek të gjithë partnerët e KI-së, si dhe postuar në mediat sociale.

INTERVISTA NË MEDIA

- » Informaliteti i Lartë i Ekonomisë dhe Përdorimi i Ulët i Kartave dhe Terminaleve Bankare (janar 2020)
- » Këshilli i Investimeve – Një Platformë Efektive Dialogu Publik-Privat (prill 2020)
- » Vizioni për të Kaluar Krizën (shtator 2020)
- » Sfidat e Investimeve (dhjetor 2020)

AUDIO & VIZUALE

- » Këshilli i Investimeve: Mundësimi i Dialogut Efektiv përmes Angazhimit Proaktiv të Aktorëve
- » Këshilli i Investimeve: Programet e Praktikës, 2017-2019

MARKETING ME E-MAIL (shpërndarja e njoftime të publikuar në faqen e internetit)

- » 823 të abonuar
- » 10 fushata në anglisht dhe shqip
- » 31% mesatarja e leximit të njoftimeve dërguar me postë elektronike

Angazhimi i partnerëve

Sekretariati shtriu bashkëpunimin ndër-institucional përmes koordinimit të grupeve të punës në sektorët prioritarë të energjisë, agroindustrisë, TIK-ut, dhe grupeve të punës teknike si p.sh. grupi i punës për trajtimin e shqetësimeve të biznesit në lidhje me bllokimin e llogarive të taksapaguesve. Kjo është arsyeja pse, përveç institucioneve të qeverisë qendrore, bashkëpunimi është zgjeruar me partnerë të rinj rajonalë si p.sh. Bashkia e Fierit, Kukësit, Pukës, Selenicës, Tropojës, si dhe Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore në MFE.

Bashkëpunimi me sektorin publik u forcua më tej veçanërisht me Ministrinë e Bujqësisë gjatë fazës përgatitore për mbledhjen e fundit plenare, si dhe me Ministrinë e Mbrojtjes së Sipërmarrjes në kuadër të konsultimit të projektligjit për start-upet inovative. Gjatë vitit 2020, KI zgjeroi më tej punën e tij me qeverinë vendore në lidhje me tematika që lidhen me taksat vendore, pronat publike, inspektimet e biznesit dhe mbështetjen për produktet agro të prodhuara në vend. Një arritje e veçantë u arrit në rritjen e bashkëpunimit me bashkitë në Veri të Shqipërisë, rritjen e bashkëpunimit me shoqatat e grave që punojnë në fushën e bimëve medicinale, etj.

Shifra të rëndësishme gjatë 2020

Gjatë vitit 2020, Këshilli i Investimeve dhe Sekretariati organizuan gjithsej 15 mbledhje me pjesëmarrjen e rreth 260 përfaqësuesve nga sektori publik dhe privat, si dhe organizatat për zhvillimi (nga të cilat 109 përfaqësues të biznesit):

- **4 mbledhje plenare** me një përqindje pjesëmarrjeje prej 97%,
- **6 mbledhje të tre grupeve të punës (energji, bujqësi, TIK)** të ngritura në janar

2020 me dekret ministror midis 3 ministrive të linjës (MFE, MIE, MBZHR) për të rritur investimet në sektorët prioritarë përkatës;

- **2 mbledhje të grupit të punës** ngritur nga Sekretariati për trajtimin e çështjes parashtruar nga biznesi **në lidhje me bllokimin e llogarive bankare nga administrata tatimore;**
- **1 mbledhje e grupit të punës** ngritur nga Sekretariati për të trajtuar çështjet e parashtruara nga biznesi në lidhje me taksat vendore dhe marrëdhëniet e tyre me bashkitë, me pjesëmarrjen e 6 bashkive;
- **1 seminar informues për skemat e garantimit të kredisë** në bashkëpunim me Bankën Botërore me pjesëmarrjen e **12** bankave kryesore lokale dhe shoqatave të mikrokredisë;
- **1 mbledhje konsultimi mbi draft ligjin e start-upeve inovative** në bashkëpunim me Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes me pjesëmarrjen e **34** NVM-ve.

Në mbledhjet e tij plenare mbajtur në muajt prill dhe maj, KI tërhoqi vëmendjen e organizatave diplomatike të huaja në vend të cilat shprehën interesin e tyre për të marrë pjesë në debat, si p.sh. Zyra e Kombeve të Bashkuara, Zyrat e Bashkëpunimit për Zhvillim nga Ambasada e Suedisë, Austrisë, Gjermanisë, OSBE, etj. Pjesëmarrja në takime i dha mundësinë këtyre agjencive të informoheshin mbi perceptimet e biznesit për problematikat e tyre më emergjente gjatë krizës së Covid-19, për t'i transpozuar ato në rekomandime për ndërhyrje të shënjestruar nga ana e qeverisë.



TË TJERA

Avokim dhe ndërgjegjësim



LEHTËSIMI I BASHKËPUNIMIT MIDIS INSTITUCIONEVE PUBLIKE

Avokim dhe ndërveprim në nivel të lartë (MFE, ministrinë e linjës, shoqata), gjatë situatës së jashtëzakonshme, ndjekur me monitorimin/koordinimin/raportimin e aktiviteteve të grupit të punës përmes raporteve periodike (agro-përpunim, TIK), kabineti i MFE.

NXITJA E DIALOGUT PUBLIK-PRIVAT

Kriza e Covid-19 ri-konfirmoi rëndësinë unike të komunikimit të qëndrueshëm dhe partneritetit shtet-privat për mirëfunksionimin e ekonomisë dhe zbutjen në kohë të pasojave të krizës shëndetësore. Platforma e KI u përdor për konsultime të rëndësishme me biznesin (p.sh. konsultimi i projektligjit për star-upet, mbledhja e jashtëzakonshme mbi Covid-19 me fokus rimëkëmbjen e ekonomisë, etj.).

FORCIMI I BASHKËPUNIMIT ME PARTNERËT PËR ZHVILLIM NË SHQIPËRI

Mbledhjet plenare të KI tërhoqën vëmendjen e partnerëve të rëndësishëm për zhvillim, veçanërisht gjatë fillimit të pandemisë, duke treguar solidaritet me komunitetin e biznesit dhe gatishmëri për të bashkuar forcat për kapërcimin e situatës.

PROMOVIMI I PRODUKTEVE “MADE IN ALBANIA”

Duke theksuar nevojën për të diskutuar një listë produktesh/industrish “strategjike” për vitet që vijnë, që

ndoshta edhe duhet të mbështeten në mënyrë të qëndrueshme me politika me synimin që të garantohet një “niche” specifike për konkurrueshmërinë e ekonomisë shqiptare në kohën e duhur.

AVOKIM PËR PËRMIRËSIMIN E INFLUENCIMIT TË KI NË MIRËQEVERISJEN E VENDIT

- » Një avokim i veçantë bërë nga partnerët tanë (MFE, projekte zviceriane, BB, etj.), përmes dokumenteve të ndryshme të cilat i referohen punës së KI dhe rekomandimeve për promovimin e reformës në inovacion, sektorin e BPO-ve apo luftimin e informalitetit në turizëm, duke përfshirë gjetjet e studimeve të KI për analiza të mëtejshme, etj.
- » Dokumentet analitike të KI janë pasqyruar në mediat (elektronike dhe vizive), si një platformë ku zëri i biznesit përcillet me paanshmëri.

NETWORKING ME PARTNERË

- » Pjesëmarrje në aktivitete të ndryshe dhe avokim nga Sekretariati në rolin e panelistit në aktivitete kombëtare dhe rajonale si Inn Fest, DiGI Diaspora, Connect Roundtable, Mbledhja e Bordit e Confindustria Italia, etj.
- » Anëtarësimi i Sekretariatit në komitetin drejtues të disa projekteve me financim zvicerian si p.sh. RisiAlbania dhe “Aftësi për Punë”, duke kontribuar në mënyrë aktive në direktivat strategjike dhe duke sjellë në vëmendje përaftrimin me rekomandimet përkatëse të KI.




Vrojtim mbi ndikimin e Covid-19 tek biznesi (2020)


- » **Si** po i përgjigjen bizneset situatës së paprecedentë shkaktuar prej pandemisë së Covid-19 dhe cilat janë sfidat me të cilat duhet të përballen përsa i përket likuiditetit, mungesës së prodhimit, mungesës së klientëve, rritjes së kostove, etj.
- » **Si** e vlerësojnë ndikimin e Covid-19 në xhiron vjetore të biznesit të tyre?
- » **Në** ç' mënyrë qeveria qendrore dhe lokale mund të ndihmojnë më mirë bizneset për nevojat e tyre specifike gjatë kësaj periudhe?

Anketat janë instrumente të vlefshme për angazhimin dhe gjithëpërfshirjen e biznesit (sipas metodologjisë poshtë-lart), tashmë pjesë e punës së KI-së që prej vitit 2015. Anketa e KI-së për vitin 2020 u përgatit nga Sekretariati në formën e një pyetësi të strukturuar, e cila u plotësua përmes internetit në mënyrë rastësore nga 833 kompani në të gjithë Shqipërinë. Qëllimi i studimit ishte grumbullimi i perceptimeve të biznesit në lidhje me efektet e mundshme të pandemisë së Covid-19 në aktivitetet e tyre të biznesit, si dhe një perceptim paraprak mbi ndërhyrjen e qeverisë në këtë aspekt. Nga 833 ndërmarrje të anketuara, 37% ishin kompani me deri në 4 të punësuar, ndërsa eksportuesit përbënin 27% të kampionit të vërtimit.

Shpërndarja e kampionit sipas të punësuarve



Shpërndarja e kampionit sipas aktivitetit ekonomik



Planet për të ardhmen

KI pritet të vazhdojë të luajë një rol kryesor në lehtësimin e dialogut midis qeverisë dhe sektorit privat, duke kontribuar në rikthimin e besimit në vend për investitorët, forcimin e mjedisit të biznesit dhe adresimin e sfidave afat-mesme dhe afat-gjata me të cilat po përballen bizneset si pasojë e pandemisë. Axhenda e KI për 2021 do të votohet nga anëtarët e tij bazuar mbi një listë me problematika kryesore të biznesit të identifikuara dhe shqyrtuara nga Sekretariati për t'iu dhënë përparësi gjatë vitit të ardhshëm. Vlen për t'u theksuar se në 17 nga 22 mbledhjet plenare të KI të mbajtura gjatë viteve 2015-2020, tema e diskutimit është votuar nga anëtarët e KI.

Gjatë vitit 2021, KI pritet të mbledhet në 4 mbledhje plenare, ndërsa Sekretariati do të vazhdojë me organizimin e mbledhjeve konsultuese dhe mbledhjeve të grupeve teknike për të siguruar një angazhim të gjerë të aktorëve nga sektori publik dhe privat. Gjithashtu, për të dytën herë, Sekretariati do të kryejë një vërtim mbarëkombëtar mbi ndikimin e Covid-19 mbi biznesin (në përpjekje për të bërë një krahasim me gjetjet e vërtimit të vitit 2020), ndërsa do të vazhdojë të monitorojë me kujdes zbatimin e rekomandimeve të miratuara nga KI dhe të rrisë ndërgjegjësimin për aktivitetet dhe impaktin e KI.

Numra të rëndësishëm, 2020



Anëtarë të KI gjatë 2020

Anëtar, Institucion Shtetëror	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Anëtar, Institucion Shtetëror	Ministria e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes
Anëtar, Institucion Shtetëror	Banka e Shqipërisë
Anëtar, Institucion Shtetëror	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA)
Anëtar, Institucion Shtetëror	Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës
Anëtar, Partner për Zhvillim	Banka Botërore
Anëtar, Partner për Zhvillim	Delegacioni i BE-së në Shqipëri
Anëtar, Partner për Zhvillim	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH)
Anëtar, Partner për Zhvillim	Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC)
Anëtar i Biznesit me Mandat të Përhershëm	Dhoma e Industrisë dhe Tregtisë Tiranë
Anëtar i Biznesit me Mandat të Përhershëm	Unioni i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë (UCCIAL)
Anëtar i Biznesit me Mandat të Përhershëm	Dhoma Shqiptare e Diasporës
Anëtar i Biznesit me Mandat 2-Vjeçar	Shoqata e Investitorëve të Huaj në Shqipëri (FIAA)
Anëtar i Biznesit me Mandat 2-Vjeçar	Dhoma Amerikane e Tregtisë (AmCham)
Anëtar i Biznesit me Mandat 2-Vjeçar	Dhoma Gjermane e Tregtisë dhe Industrisë në Shqipëri (DIHA)
Anëtar i Biznesit me Mandat 2-Vjeçar	Confindustria Albania
Anëtarë Biznesi me Mandat të Posaçëm	Essegei S.p.A. Edipack sh.p.k. Easy Pay sh.p.k. Agrotech Vodafone Albania Sam sh.p.k. Doni Fruits sh.p.k. MEIA sh.p.k.

RAPORTI MBIN AKTIVITETIN E KI²⁰²⁰

Transformimi i dialogut në format të ri

Sekretariati i Këshillit të Investimeve - Staf

Puna e Këshillit të Investimeve mbështetet nga Sekretariati, një organ i pavarur me profesionistë të përzgjedhur dhe kontraktuar nga BERZH për t'u angazhuar drejtpërsëdrejti me komunitetin e biznesit.

Dr. Diana Leka (Angoni)

Drejtoare e Sekretariatit
lekad@investment.com.al

Elvis Zerva

Ekspert Ligjor dhe Pregullator
zervae@investment.com.al

Elida Fara

Eksperte Ekonomie
farae@investment.com.al

Xaira Shurdha

Eksperte për Monitorimin dhe Bashkëpunimin
shurdhax@investment.com.al

Elisa Lula

Oficere Administrative dhe Komunikimi
lulae@investment.com.al

Publikuar nga Sekretariati i Këshillit të Investimeve (SKI), Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri
info@investment.com.al / www.investment.com.al / SKI është përgjegjës për përmbajtjen e këtij publikimi.

 Albania Investment Council  ALInvestCouncil  Albania Investment Council



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, BERZH dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO).